



BASHKIA PUSTEC



PLANI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026 -2028



1. Hyrje dhe konteksti	6
Konteksti administrativ	6
Të dhëna demografike	6
Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor	8
2. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025	9
Shpërndarja e mbulimi i shërbimeve Arsimore dhe Parashkollore në Bashkinë Pustec	9
Rrjeti i shkollave në njësinë administrative Pustec	9
• Aksesueshmëria	10
• Frekuentimi	10
• Kapaciteti dhe mobilimi	10
• Nevojat për investime	10
• Shërbimet bazë dhe siguria	10
• Përfshirja sociale	10
• Qeverisja në shkolla	11
Rrjeti i kopshteve në njësinë administrative Pustec	11
• Aksesueshmëria	11
• Frekuentimi në Arsimin Parashkollor (3–6 vjeç)	11
• Burimet njerëzore	11
• Infrastruktura dhe sipërfaqet	11
• Nevojat për rikonstrukcion dhe pajisje	11
3. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar	12
Vizioni	12
Përmbledhje e Qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve	12
Përmbledhje e investimeve kapitale (2026–2028)	14
4. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar	15
Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar	15
5. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)	16
6. Plani i investimeve kapitale	24
7. Monitorimi dhe vlerësimi	25
Indikatorët e Performancës	25
Planifikimi i vlerësimit të progresit	25
Përfshirja e aktorëve të jashtëm	25
Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi	25
Monitorimi i realizimit të aktiviteteve	25

Vlerësimi i ndikimit në komunitet	26
8. Rishikimi dhe përshtatja e planit	26
Procesi i rishikimit	26
Përshtatja e masave dhe aktiviteteve	27
9. Raportimi dhe transparenca.....	27
10. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar.....	28
11. Aneks 2: Të dhëna për kopshtet në Bashkinë Pustec	29
12. Aneks 3: Të dhëna për shkollat në Bashkinë Pustec	30

Parathënie

Plani i Arsimit Parauniversitar i Bashkisë Pustec përfaqëson një dokument strategjik me rëndësi të veçantë për zhvillimin social, kulturor dhe njerëzor të komunitetit tonë. Duke pasur në thelb fëmijën si qendër të vëmendjes, ky plan synon të orientojë politikën dhe investimet tona drejt ndërtimit të një sistemi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm për çdo familje në territorin e bashkisë.

Në një zonë të veçantë si Pusteci, me trashëgimi kulturore, gjuhësore dhe natyrore unike, arsimi është jo vetëm një mjet për zhvillim, por edhe një mjet për ruajtjen e identitetit. Prandaj, Plani i Arsimit Parauniversitar është hartuar në përputhje me nevojat reale të komunitetit dhe sfidat lokale, duke u mbështetur në të dhëna konkrete, vlerësime të thelluara dhe pjesëmarrjen e aktorëve lokalë.

Vizioni që na udhëheq është:

“Të garantojmë një arsim të aksesueshëm, gjithëpërfshirës dhe me cilësi për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Pustec, duke ndërtuar institucione arsimore që respektojnë diversitetin kulturor, forcojnë zhvillimin komunitar dhe përgatisin të rinjtë për një të ardhme aktive dhe të qëndrueshme.”

Si Kryetar i Bashkisë Pustec, unë jam personalisht i angazhuar për zbatimin me përkushtim të këtij plani. Do të punojmë për të përmirësuar infrastrukturën ekzistuese, për të garantuar mbështetje për stafin arsimor dhe për të forcuar bashkëpunimin me komunitetin e prindërve dhe institucionet partnere. Bashkia do të vijoje të kërkojë mbështetje teknike dhe financiare për të realizuar objektivat e këtij plani dhe për të siguruar që asnjë fëmijë të mos mbetet jashtë sistemit arsimor për shkak të vendbanimit, përkatësisë kulturore apo kushteve ekonomike.

Ky dokument është më shumë se një plan: ai është një angazhim i përbashkët për të investuar në të ardhmen e fëmijëve tanë dhe në forcimin e shoqërisë sonë.

Pali Kolefski,

Kryetar i Bashkisë Pustec

Falënderime

Bashkia Pustec shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë angazhimin e Këshillit Bashkiak të Pustecit, për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për angazhimin e strukturave të tij në sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale, si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që ofruan informacion të vlefshëm dhe reflektim mbi nevojat reale në terren.

Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, të cilët morën pjesë në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioritetëve të komunitetit.

Ky plan përfaqëson një vullnet të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Pustec.

1. Hyrje dhe konteksti

Konteksti administrativ

Bashkia Pustec përbëhet nga një njësi administrative unike, që mbulon një territor me karakteristika të ndërthurura urbane dhe rurale. Kjo strukturë e thjeshtuar administrative, e shtrirë në 9 fshatra dhe me qendër në fshatin Pustec, përfaqëson një realitet të veçantë në hartën vendore të Shqipërisë, duke qenë e banuar kryesisht nga komuniteti i minoritetit maqedonas.

Në këtë territor, organizimi dhe ofrimi i shërbimeve publike – përfshirë arsimin parauniversitar – ndikohet nga faktorë të tillë si:

- **Gjeografia e veçantë** pranë Liqenit të Prespës,
- **Popullsia e shpërndarë**, dhe
- **Burimet njerëzore dhe infrastrukturore të kufizuara.**

Me një sipërfaqe prej 198.68 km² dhe një popullsi që varion nga 1,843 banorë sipas Censurit 2023, Bashkia Pustec përballlet me sfida në sigurimin e aksesit të barabartë dhe cilësisë së qëndrueshme të shërbimeve arsimore në çdo fshat. Kjo kërkon një qasje të përshtatur dhe të ndjeshme ndaj kontekstit lokal, për të garantuar një edukim gjithëpërfshirës dhe të barabartë për çdo fëmijë.

Njësia administrative Pustec, si e vetmja strukturë nën administrimin e bashkisë, përbën bazën e ofrimit të shërbimeve arsimore parauniversitare – kopshteve dhe shkollave publike – në një zonë që ruan trashëgimi kulturore dhe natyrore të veçantë, si ishulli i Maligradit dhe monumentet e lashta buzë liqenit. Po ashtu, potenciali i turizmit veror dhe i trashëgimisë natyrore shton rëndësinë e edukimit cilësor dhe të ndërlidhur me zhvillimin e qëndrueshëm lokal.

Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Pustec është 1,843 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 931 meshkuj dhe 912 femra. Struktura e popullsisë karakterizohet nga një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve në moshë parashkollore dhe të rinjve, gjë që nënvizon rëndësinë e zhvillimit dhe forcimit të shërbimeve arsimore në këto kategori.

Gjinia	Popullsia
Femer	912
Mashkull	931

Të dhënat demografike sipas grupmoshave (fëmijë dhe të rinj)

Struktura demografike e Bashkisë Pustec pasqyron një shtrirje të kufizuar të popullsisë në moshat e reja, çka ka ndikim të drejtpërdrejtë në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve arsimore në nivel vendor.

Sipas të dhënave më të fundit:

- **42 fëmijë** i përkasin grupmoshës **0–4 vjeç**, që përbën potencialin aktual për përfshirje në arsimin parashkollor (kopshtet).
- **49 fëmijë** janë në grupmoshën **5–9 vjeç**, të cilët përfshihen në arsimin fillor.

- **61 fëmijë** janë në grupmoshën **10–14 vjeç**, që korrespondon me ciklin e dytë të arsimit bazë.
- **68 të rinj** ndodhen në grupmoshën **15–19 vjeç**, pjesë e arsimit të mesëm të ulët ose të lartë.

Kjo shpërndarje tregon një rritje të lehtë të numrit të nxënësve në grupmoshat më të mëdha, duke sugjeruar tendencën e reduktimit të lindshmërisë dhe një strukturë të plakur të popullsisë në vitet në vijim. Kjo nënvizon rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm për të ruajtur funksionalitetin e institucioneve ekzistuese, si dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve në funksion të qëndrueshmërisë së komunitetit.

Grupmosha	Popullsia sipas Grupmoshës
0-4 vjeç	42
5-9 vjeç	49
10-14 vjeç	61
15-19 vjeç	68

Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor

Në Bashkinë e Pustecit, detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit parauniversitar përcaktohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjik kombëtar që rregullon funksionimin e sistemit arsimor në Republikën e Shqipërisë.

Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton strukturën, nivelet dhe përmbajtjen e arsimit – përfshirë arsimin parashkollor, bazë, të mesëm të përgjithshëm – si dhe ndan përgjegjësitë ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore për garantimin e cilësisë, gjithëpërfshirjes dhe funksionalitetit të sistemit arsimor.

Në mënyrë plotësuese, **Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”** i njeh njësive të qeverisjes vendore, përfshirë Bashkinë Pustec, kompetenca të drejtpërdrejta në ofrimin dhe menaxhimin e shërbimeve të arsimit parashkollor. Në këtë kuadër, Bashkia është përgjegjëse për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike në territorin e saj, përfshirë sigurimin e infrastrukturës, logjistikës dhe stafit ndihmës.

Sa i përket arsimit bazë dhe të mesëm, kompetencat kryesore mbeten në nivelin qendror, përmes Ministrisë së Arsimit dhe strukturave vendore të saj. Megjithatë, Bashkia Pustec luan një rol të rëndësishëm mbështetës, sidomos në:

- menaxhimin dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore,
- lehtësimin e transportit për nxënësit,
- mbështetjen e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta,
- garantimin e kushteve të sigurisë dhe
- bashkëpunimin me komunitetin.

Në funksion të këtij kuadri, Bashkia harton dhe zbaton politika vendore në arsim, të cilat përputhen me prioritetet kombëtare por janë të ndërtuara mbi nevojat konkrete të territorit. Këto politika përfshihen në dokumente planifikimi si i përgjithshëm vendor dhe plane sektoriale për arsimin, që adresojnë aspekte si shpërndarja gjeografike e popullsisë shkollore, kapacitetet e infrastrukturës ekzistuese, burimet njerëzore në dispozicion, përfshirja sociale dhe nevojat e bashkëpunimit ndërinstitutional.

Bashkia Pustec bashkëpunon ngushtësisht me Zyrën Vendore Arsimore (ZVA) dhe institucionet arsimore lokale për të siguruar zbatimin e standardeve dhe politikave arsimore. Ky bashkëpunim shtrihet në fusha si:

- rikonstruksioni dhe funksionalizimi i objekteve shkollore,
- menaxhimi i situatave emergjente,
- procesi i regjistrimit të nxënësve,
- identifikimi dhe përfshirja e fëmijëve që rrezikojnë të mbeten jashtë sistemit arsimor.

Në këtë mënyrë, Bashkia e Pustecit vepron si aktor lokal kyç në zbatimin e politikave arsimore, duke kontribuar në ndërtimin e një sistemi arsimor të aksesueshëm, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt cilësisë për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e komunitetit.

2. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025

Shpërndarja e mbulimi i shërbimeve Arsimore dhe Parashkollore në Bashkinë Pustec

Rrjeti arsimor i Bashkisë Pustec është organizuar në mënyrë që të **përmbushë nevojat e komunitetit lokal** në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Institucionet janë të vendosura në pika strategjike që mundësojnë mbulim të gjerë dhe akses të qëndrueshëm, duke reduktuar distancat për fëmijët dhe nxënësit dhe duke kontribuar në **përfshirjen sociale dhe zhvillimin e komunitetit**.

Lista e Shkollave dhe vendndodhja

Emri i Shkollës	Vendndodhja	Nivelet që ofron
Shkolla e Bashkuar “Dy Dëshmorët”	Pustec	Kopsht, Fillore, 9-vjeçare, Mesme
Shkolla “Rezistenca e Goricarëve”	Dollna Gorica	Kopsht, Fillore
Shkolla Fillore Tuminec	Tuminec (Kallamas)	Kopsht, Fillore
Shkolla Fillore Leska	Leska (Lajthizë)	Kopsht, Fillore
Shkolla Fillore Shulin	Shulin (Diellas)	Kopsht (shkolla ndjeket në Pustec)

Rrjeti i shkollave në njësinë administrative Pustec

Në Bashkinë Pustec funksionojnë gjithsej **5 institucione arsimore publike (shkolla)**, të shpërndara në zonat urbane dhe rurale, që përfshijnë:

- **4 shkolla fillore:** Shkollat fillore u shërbejnë fëmijëve në fazat e para të edukimit, duke u ofruar njohuritë bazë në lexim, shkrim, matematikë dhe lëndë të tjera themelore. Ato janë të përhapura në mënyrë të tillë që të jenë sa më pranë vendbanimeve për të siguruar akses të lehtë për nxënësit e vegjël.
- **2 shkolla 9-vjeçare:** Shkollat 9-vjeçare, gjithsej 2 në numër, përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor.
- **1 shkollë e mesme:** Shkolla e mesme synon të formojë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare apo për përgatitje për tregun e punës.

Shumë prej këtyre institucioneve janë të bashkëvendosura në të njëjtën godinë me kopshtet, duke mundësuar eficiencë në përdorimin e infrastrukturës dhe lehtësi në akses për familjet.

Të gjitha shkollat ndodhen në territorin e Bashkisë Pustec dhe janë të klasifikuara si institucione të arsimit parauniversitar të vendosura në qendrat e banuara si Pustec, Leska, Shulin, Tuminec dhe Dollna Gorica. Ky pozicionim i shpërndarë pasqyron përpjekjen për të mbuluar me arsim fëmijët në të gjithë njësinë administrative të bashkisë.

Aksesueshmëria

Shumica e shkollave kanë një distancë të arsyeshme nga zonat e banimit (0–5 km), megjithatë mungojnë të dhënat për aksesin e sigurt për këmbësorë, sinjalistikën dhe ndriçimin rrugor në hyrje të shkollave, çka nënvizon nevojën për përmirësim të infrastrukturës së jashtme për rritjen e sigurisë së nxënësve.

Frekuentimi

Frekuentimi në Arsimin fillor (klasat 1–5): Nxënës të regjistruar: **34** (21 djem – 61.5%, 13 vajza – 38.5%)

Frekuentimi në Arsimin 9-vjeçar (klasat 1–9): Nxënës të regjistruar: **35** (21 djem – 60%, 14 vajza – 40%). Frekuentimi është i qëndrueshëm, por tregon gjithashtu nevojën për **monitorim të vazhdueshëm, sidomos për vajzat**.

Frekuentimi në Arsimin e mesëm: Nxënës të regjistruar: **11** (4 djem – 36.4%, 7 vajza – 63.6%)

Kapaciteti dhe mobilimi

Pjesa më e madhe e shkollave kanë sipërfaqe funksionale, ndërtesa të përmasave mesatare dhe një numër klasash të kufizuar. Përdorimi i klasave dhe mobilimi me karrige dhe banka mbetet në disa raste i paplotë. Tualetet dhe lavamanët janë shpesh në numër të ulët, duke ndikuar në higjienën dhe mirëqenien e nxënësve.

Nevojat për investime

Disa shkolla kanë nevojë të drejtpërdrejtë për rikonstrukcion, sidomos në drejtim të tualeteve të përshtatshme për grup-moshën dhe mobilimit të brendshëm. Kërkohen investime në pajisje didaktike, laboratorike dhe teknologjike (kompjuterë, projektorë, pajisje për mësim të asistuar), ndërsa disa shkolla janë aktualisht në proces rikonstrukcioni.

Shërbimet bazë dhe siguria

Shërbimet themelore si furnizimi me ujë të pijshëm, energji elektrike dhe ngrohje janë të pranishme në shkolla, por jo të standardizuara. Interneti dhe telefoni mungojnë në shumicën e shkollave. Furnizimi me artikuj higjienikë (letër, sapun, dezinfektues) nuk është i garantuar në mënyrë të qëndrueshme.

Përfshirja sociale

Në disa shkolla është evidentuar prania e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe raste të veçuara të fëmijëve që nuk janë të regjistruar. Rastet e fëmijëve në situatë ruge apo me asistencë sociale janë të pakta, por raportimi i mungesave dhe arsyeve mbetet jo i plotë. Kjo evidenton nevojën për monitorim më të mirë dhe shërbime mbështetëse psiko-sociale.

Qeverisja në shkolla

Disa shkolla kanë borde të institucionalizuara që përfshijnë përfaqësues të prindërve, stafit pedagogjik, pushtetit vendor dhe nxënësve. Bordi mbledhet çdo 3 muaj.

Rrjeti i kopshteve në njësinë administrative Pustec

Aktualisht janë funksionale **5 kopshte** publike, që ofrojnë edukim dhe kujdes për fëmijët 3–6 vjeç. Ato janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të garantojnë **akses të barabartë** edhe në zonat më të thella.

Lista e kopshteve:

- Kopshti Pustec
- Kopshti Dolna Gorica
- Kopshti Tuminec
- Kopshti Leska
- Kopshti Shulin

Aksesueshmëria

Rrjeti i kopshteve në Bashkinë Pustec mbulon zonat kryesore të territorit, por përballët me sfida të mëdha në infrastrukturë, staf, pajisje dhe standardet e mjedisit. Përmirësimi i kushteve të godinave, sigurimi i stafit të mjaftueshëm dhe pajisjeve didaktike, si dhe garantimi i shërbimeve bazë për fëmijët janë prioritetë urgjentë për të siguruar edukim cilësor dhe të sigurt në fëmijërinë e hershme.

Frekuentimi në Arsimin Parashkollor (3–6 vjeç)

Në total, në këto kopshte janë të regjistruar 21 fëmijë, me shtrirje të ndryshme nga 7 fëmijë në Pustec deri në 2 fëmijë në Leska dhe Shulin.

- Numri total i fëmijëve: **21** (10 djem, 11 vajza)
- Përfshirja: 100% e fëmijëve ndjekin institucionet parashkollore

Burimet njerëzore

Numri i edukatoreve është i kufizuar bazuar në numrin e fëmijëve, me shumicën e kopshteve që kanë 1–2 edukatore, ndërsa vetëm një kopsht raporton praninë e një ndihmëse edukatoreje.

Infrastruktura dhe sipërfaqet

Sipërfaqja e përgjithshme e pronës së kopshteve varion nga 613 m² (Leska) deri në 3000 m² (Dolna Gorica), ndërsa ndërtesat kanë sipërfaqe që lëvizin nga 100 m² në Pustec deri në 500 m² në Tuminec.

Nevojat për rikonstruksion dhe pajisje

Të gjitha kopshtet paraqesin nevojë për rikonstruksion, kryesisht në drejtim të infrastrukturës sanitare. Disa kopshte si Leska dhe Shulin kanë nevojë edhe për ndërhyrje më të gjera infrastrukturore. Kjo tregon një sfidë të rëndësishme për sigurinë dhe higjienën e ambienteve që frekuentohen nga fëmijët.

3. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar



Vizioni

“Të garantojmë një arsim të aksesueshëm, gjithëpërfshirës dhe me cilësi për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Pustec, duke ndërtuar institucione arsimore që respektojnë diversitetin kulturor, forcojnë zhvillimin komunitar dhe përgatisin të rinjtë për një të ardhme aktive dhe të qëndrueshme.”

Përmbledhje e Qëllimeve, objektivate dhe aktiviteteve

Duke u mbështetur në rrjetin ekzistues të institucioneve arsimore, nga kopshtet deri në shkollat e mesme dhe duke adresuar sfidat aktuale të aksesit, infrastrukturës dhe përfshirjes gjinore, Bashkia Pustec ka për synim:

- **Përmirësimin e infrastrukturës arsimore**, veçanërisht në zonat rurale, për të garantuar kushte dinjitoze mësimi në çdo shkollë e kopsht;
- **Përmirësimin e përfshirjes në arsimin parashkollor**, duke mbështetur prindërit dhe rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e edukimit të hershëm;
- **Zvogëlimin e pabarazive gjinore dhe sociale** në ndjekjen e shkollës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;

- **Rritjen e cilësisë së mësimdhënies**, përmes investimit në zhvillimin profesional të mësuesve dhe përdorimin e metodologjive bashkëkohore;
- **Forcimin e partneriteteve me komunitetin dhe institucionet arsimore** për të mbështetur suksesin e çdo nxënësi.

Qëllimi 1 (Q1) Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, funksional dhe gjithëpërfshirës

Të garantohen kushte të qëndrueshme infrastrukturore dhe funksionale për të gjitha institucionet arsimore në territorin e Bashkisë Pustec, përmes mirëmbajtjes sistematike dhe investimeve të orientuara drejt standardeve bashkëkohore.

- **Objektivi 1.1** – Të sigurohet ofrimi i shërbimeve mbështetëse në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive, duke përfshirë pagesat e personelit mësues në arsimin parashkollor dhe personelit ndihmës në kopshte dhe shkolla, mirëmbajtjen e ambienteve shkollore, përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, funksionimin e sistemeve të ngrohjes, furnizimin me kancelari, mjete didaktike, ushqim, dokumentacion dhe transport.
- **Objektivi 1.2** – Të investohet në përmirësimin e infrastrukturës arsimore, përmes ndërtimit ose rikonstruksionit të kopshteve dhe institucioneve arsimore, pajisjes me mobilie si dhe ngritjes së një sistemi elektronik për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të institucioneve arsimore.

Qëllimi 2 (Q2) Mbështetje për zhvillimin e plotë të fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar

Të sigurohet zhvillimi emocional, social dhe kognitiv i çdo fëmije përmes shërbimeve edukative gjithëpërfshirëse dhe mbështetjes psiko-sociale në mjedise të sigurta dhe përkujdesëse.

- **Objektivi 2.1** – Të përmirësohet cilësia e edukimit në institucionet parashkollore përmes mbështetjes së kopshteve me mjete dhe organizimit të trajnimeve për edukatorët dhe ngritjes së kapaciteteve të stafit për të ofruar një edukim të hershëm gjithëpërfshirës dhe bashkëkohor.
- **Objektivi 2.2** – Të forcohet përkujdesja sociale për fëmijët përmes angazhimit të mësuesve ndihmës, ofrimit të shërbimeve psiko-sociale, krijimit dhe fuqizimit të strukturave menaxhuese pjesëmarrëse (këshillat e prindërve dhe bordet e shkollës), si dhe mbështetjes së nxënësve nga familjet në nevojë apo me rezultate të larta.

Qëllimi 3 (Q3) Zhvillimi i talenteve dhe ndjesisë së përkatësisë përmes veprimtarive jashtëmësimore

Të promovohet zhvillimi i potencialit krijues, fizik dhe social të fëmijëve përmes një kalendari të pasur aktivitetesh jashtëmësimore që nxisin shëndetin, bashkëpunimin dhe përfshirjen komunitare.

- **Objektivi 3.1** – Të organizohen rregullisht veprimtari kulturore, sportive dhe ndërgjegjësuëse, si: ngjarje artistike, ekspozita, ditë ndërkombëtare tematike, aktivitete mjedisore dhe lokale, për të nxitur zhvillimin e aftësive dhe pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në jetën shoqërore.

Përmbledhje e investimeve kapitale (2026–2028)

Plani i investimeve kapitale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Pustec për periudhën 2026–2028 parashikon një kërkesë financiare totale prej **48,025,000 lekë**. Kryesisht, ndërhyrjet do të fokusohen në:

Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Rezistenca e Goricarëve”

Ky projekt përfaqëson ndërhyrjen më të rëndësishme në aspektin financiar dhe infrastrukturor, me një vlerë totale prej 45 milionë lekësh. Rikonstruksioni synon përmirësimin rrënjësor të kushteve fizike të shkollës, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e mjedisit mësimor për nxënësit dhe stafin pedagogjik. Ky investim pritet të rrisë sigurinë, funksionalitetin dhe aksesueshmërinë e institucionit.

Pajisje për shkollat dhe kopshtet

Me një vlerë të dedikuar prej 3 milionë lekësh, ky projekt ka për qëllim pajisjen e institucioneve arsimore me orendi, mjete mësimore dhe didaktike. Investimi synon të forcojë kapacitetet pedagogjike dhe të përmirësojë cilësinë e procesit mësimor në kopshte dhe shkolla në të gjithë territorin e bashkisë.

Pajisje me mjete të fikjes së zjarrit për objektet arsimore

Ky projekt, me një vlerë më modeste prej 25,000 lekësh, fokusohet në sigurinë fizike të ambienteve shkollore, përmes instalimit apo furnizimit me mjete të fikjes së zjarrit. Edhe pse buxheti është i kufizuar, ky investim është thelbësor për përmbushjen e standardeve bazë të sigurisë në institucionet arsimore.

4. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar

Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parauniversitar

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifat vendore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje të fëmijëve nga grupe vulnerabël.
- Arsimi 9-vjeçar Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave;

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore.

Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar financimin buxhetor të shërbimit të arsimit parauniversitar, mënyrën e plaifikuar të përdorimit të fondeve publike për arsimin parauniversitar, si dhe për të identifikuar boshllëqet ose mundësitë për investime të reja në funksion të përmirësimit të cilësisë së edukimit

Për periudhën 2026–2028, buxheti total i planifikuar për arsimin parashkollor është 111249 mijë lekë, të detajuaja sipas aktiviteteve më poshtë:

Kodi i Llogarisë	Aktivitetet	Viti 2025 në mijë lekë	Viti 2026 në mijë lekë	Viti 2027 në mijë lekë	Viti 2028 në mijë lekë	Shuma në mijë lekë
600+601	Shpenzime personeli	17754	9508	9508	9508	46278
602	Shpenzime operative	4500	3000	3000	3000	13500
231	Investime	3446	19210	28815		51471
	Shuma sipas viteve	25700	31718	41323	12508	111249

Për periudhën 2025–2028, buxheti total i planifikuar për arsimin parauniversitar (shkollat) është 0 mijë lekë, të detajuaja sipas aktiviteteve më poshtë:

Kodi i Llogarisë	Aktivitetet	Viti 2025 në mijë lekë	Viti 2026 në mijë lekë	Viti 2027 në mijë lekë	Viti 2028 në mijë lekë	Shuma në mijë lekë
600+601	Shpenzime personeli	0	0	0	0	0
602	Shpenzime operative	0	0	0	0	0
231	Investime	0	0	0	0	0
	Shuma	0	0	0	0	0

5. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

Qëllimi 1 (Q1) – Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, funksional dhe gjithëpërfshirës

Objektivi specifik O1.1: Të sigurohet ofrimi i shërbimeve mbështetëse në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive, duke përfshirë pagesat e personelit mësues në arsimin parashkollor dhe personelit mbështetës në kopshte dhe shkolla, mirëmbajtjen e ambienteve shkollore, përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, funksionimin e sistemeve të ngrohjes, furnizimin me kancelari, mjete didaktike, ushqim, dokumentacion dhe transport.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Mbështetja me pagesën dhe sigurimin punonjësve e arsimit (parashkollor, bazë dhe atij të mesëm)	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Këshilli Bashkiak	46278 mije leke	Nr. i punonjësve (mësues, dhe staf mbështetës) të mbështetur financiarisht në funksion te arsimit dhe mirërritjes së fëmijeve; Nr. i fëmijëve të regjistruar në kopësht (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) që përfitojnë shërbimi i arsimit parashkollor
